

Maqedonia

Shpërndaje

ZYRA PËR MONITORIMIN DHE LUFTIMIN E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Raporti mbi trafikimin e qenieve njerëzore, 2018

Niveli 2

MAQEDONIA: Niveli 2

Qeveria e Maqedonisë nuk i plotëson të gjitha standardet minimale për eliminimin e trafikimit, megjithatë po bën përpjekje të konsiderueshme për t'i plotësuar ato. Autoritetet e shtetit demonstuan përpjekje në rritje, krahasuar me periudhën paraprake të raportimit, prandaj Maqedonia qëndroi në nivelin e dytë. Autoritetet e shtetit demonstuan përpjekje në rritje duke trajnuar përgjegjës të linjës së parë për identifikimin e viktimave dhe duke punuar me autoritetet lokale për nisjen e planeve të veprimit kundër-trafikimit.

Qeveria krijoi një grup punues kundër trafikimit, ri-vendosi ekipe mobile identifikimi në katër regjione, si dhe dërgoi punonjës socialë të bëjnë identifikim proaktiv të viktimave në kalimet kufitare dhe në kampet e migrantëve dhe refugjatëve. Megjithatë, qeveria nuk i plotësoi standardet minimale në disa fusha kyçe. Qeveria identifikoi gjashtë viktima dhe dënoi një trafikant, gjykatësit vazhduan të shqiptojnë dënime të ulta që ishin nën dënimin minimal të vet shtetit, ndërsa organet e zbatimit të ligjit pati mungesë stafi që të bënte hetime adekuate proaktive. Qeveria uli finansimin e përgjithshëm për mbrojtjen e viktimave dhe nuk u dha grante për luftimin e trafikimit OJQ-ve, përkundër asaj që OJQ-të identifikuan dhe shërbyen pjesën më të madhe të viktimave potenciale të identifikuar gjatë vitit. Korrupsioni dhe bashkëfajësia e zyrtarëve në krimet e trafikimit ngelin shqetësime qenësore; derisa qeveria akuzoi një nëpunës civil për bashkëpunim në 2017, ajo nuk ka ndjekur penalisht ndonjë zyrtar për përfshirje në krim në hetimet që i ka inicuar viteve të fundit.

REKOMANDIMET PËR MAQEDONINË

Të hetojë fuqishëm, të ndjekë penalisht, dhe të dënojë trafikantët, përfshirë zyrtarët e përfshirë, dhe të imponojë dënime të forta; të rrit përpjekjet që në mënyrë proaktive të identifikojë viktimat e trafikimit dhe të trajnojnë zyrtarët në ekzaminimin e trafikimit mes individëve në prostitucion, migrantëve, refugjatëve dhe popullatave të tjera të rrezikuara; të ndajë burime të mjaftueshme për mbrojtjen e viktimave; të sigurojë akomodim për viktimat e huaja potenciale të trafikimit në mjedis të sigurtë, përshtatshëm për rehabilitues dhe të lejojë viktimat të dalin nga strehimorja sipas dëshirës; të i ndajë burime dhe personel të mjaftueshëm njësitit të policisë së kundër-trafikimit që në mënyrë proaktive të hetojë trafikimin; t'u ofrojë trajnime të avancuara gjykatësve, prokurorëve, dhe organeve të zbatimit të ligjit në hetime dhe ndjekje penale të trafikimit; të përmirësojë mekanizmat e kompensimit për viktimat dhe të i informojë ata për të drejtën e tyre për të kërkuar dëmshpërblim; si dhe të bëjë përpjekje publike qeveritare kundër-trafikimit.

NDJEKJA PENALE

Qeveria bëri përpjekje të dobëta për zbatimin e ligjit. Nenet 418(a) dhe (d) të kodit penal penalizojnë trafikimin për seks dhe punë dhe parashohin një denim minimal prej katër viteve burg, i cili është mjaft i rreptë, dhe për sa i përket trafikimit për seks, konform dënimeve të përshkruara për krime të tjera serioze, siç është përdhunimi. Qeveria bëri hetimin e katër rasteve në vitin 2017 (dy raste në 2016). Qeveria ndoqi penalisht katër të pandehur (dy të pandehur në 2016), dhe dënoi një trafikant në vitin 2016 dhe 2017. Gjykatësit vazhduan të shqiptojnë dënime më të ulta se sa dënimi minimal që është katër vite burg; i vetmi trafikant i dënuar në vitin 2017 mori dy vite lirim me kusht, por prokurorët apeluan dhe dënimi mbeti pezull deri në fund të periudhës së raportimit.

Njësia për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të migrantëve (CTHBMSU) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) realizoi hetime të specializuara, por pjesën më të madhe të 2017 kishte mungesë stafi për të realizuar hetime proaktive adekuate. MPB-ja trajnoi 718 oficerë policie mbi çështjet e trafikimit, ndërsa Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) trajnoi 25 inspektorë mbi çështjet e punës së detyruar. Qeveria formoi një grup punues për luftimin e trafikimit, kurse organet e zbatimit të ligjit bënë hetime të përbashkëta me Shqipërinë, Greqinë, Serbinë dhe Malin e Zi. Korrupsioni dhe bashkëfajësia e zyrtarëve në krimet e trafikimit mbetën shqetësime të mëdha. Në vitet e mëparshme, dëshmitarë të ndryshëm raportuan se disa policë dhe inspektorë të punës mbase kishin pranuar ryshfet nga trafikantët, ndërkohë që autoritetet dyshuan se pronarët e bareve dhe shtëpive publike ishin paralajmëruar përpara bastisjeve të policisë. Qeveria akuzoi një nëpunës civil për bashkëpunim në trafikim në 2017. Në 2016, qeveria akuzoi një inspektor komunal për trafikim dhe tre oficerë policie mbetën nën hetime që nga viti 2014 për dyshime në përfshirje në organizata të angazhuara në trafikim; qeveria nuk raportoi progres për ato raste.

MBROJTA

Organet e pushtetit vazhduan përpjekjet për mbrojtjen e viktimave. ato identifikuan gjashtë viktima në periudhën raportuese (gjashtë në 2016). Nga këto, katër viktima i ishin nënshtruar trafikimit për seks, një trafikimit për seks dhe për punë të detyruar, dhe një për punë të detyruar (gjashtë i ishin nënshtruar trafikimit për seks në 2016); pesë ishin fëmijë (tre në 2016); dhe pesë ishin femra dhe tjetri mashkull (gjashtë femra në 2016). Qeveria dhe OJQ-të gjithashtu identifikuan 99 viktima potenciale të trafikimit në 2017 (125 në 2016); 57 ishin të rritur dhe 42 ishin fëmijë. MPPS riformoi ekipe mobile të identifikimit në katër regjione për popullatën në rrezik, përfshirë për viktimat e trafikimit, dhe vazhdoi të dërgojë punonjësit socialë të bëjnë identifikim proaktiv të viktimave në kalimet kufitare dhe kampet e migrantëve dhe të refugjatëve; MPPS identifikoi një viktimë zyrtare (një viktimë potenciale në 2016). Qeveria trajnoi përgjegjësit e linjës së parë për identifikimin e viktimave, përfshi oficerë të policisë, inspektorë të punës, mësues, zyrtarë të migracionit, dhe punonjës socialë. Megjithatë, ekspertët raportuan që shumica e agjencive qeveritare nuk kishte bërë përpjekje proaktive të identifikimit. Zyrtarët ekzaminuan për indikatorë trafikimi në vendkalimet kufitare, por punonjësit kufitarë nuk i identifikuan viktimat sipas rregullit. Punonjësit socialë të MPPS-së dhe policia vazhduan të identifikojnë viktimat potenciale të punës së detyruar kryesisht në mesin e fëmijëve romë të angazhuar për të lypur dhe për të shitur në rrugë. Qeveria i vendosi në qendra për kujdes ditor dhe i paralajmëroi, i gjobiti, ose i burgosi prindërit e tyre; në rastet kur gjykata vlerësoi se prindërit ishin të paafhtë për t'u kujdesur për fëmijët e tyre, shteti i vendosi fëmijët në jetimore.

Përgjegjësit e linjës së parë i referuan viktimat potenciale tek CTHBMSU dhe MPPS, të cilat ishin të autorizuar për identifikimin zyrtar të viktimave. Qeveria referoi 15 viktima potenciale të trafikimit dhe shoqëria civile referoi 84 viktima potenciale (56 ishin fëmijë dhe 41 ishin fëmijë),

krahasuar me 36 viktimat potenciale të referuara nga qeveria dhe 89 nga shoqëria civile në vitin 2016. Qeveria dhe OJQ-të u ofruan viktimave potenciale dhe viktimave të njohura zyrtarisht mbrojtje dhe ndihmë, përfshirë ushqim, veshëmbathje, ndihmë mjekësore, përkrahje psiko-sociale, rehabilitim, dhe shërbime ri-integrimi. Shërbimet sociale të udhëhequra nga MPPS poashtu punësuan staf të specializuar dhe ofruan përkrahje psiko-sociale dhe ndihmë për ri-integrim, si dhe për arsimim dhe gjetjen e një vendi pune. Megjithatë, viktimat potenciale të trafikimit nuk kishin qasje tek strehimorja qeveritare dhe shërbimet e përkujdesjes derisa nuk u njohën zyrtarisht nga qeveria si viktimë, ndërkohë që GRETA raportoi se viktimat zyrtarisht të njohura nuk pranuan asnjë njoftim formal, gjë e cila ua shkurtoi të drejtën për ndihmë mjekësore dhe ligjore falas. Ndihma e specializuar nuk ishte e disponueshme për viktimat e gjinisë mashkullore, ndërsa dëshmitarë të ndryshëm raportuan vetëm një viktimë të punës së detyruar që kishte marrë mbështetje për ri-integrim. Qeveria drejtoi një strehimorje për viktimat e trafikimit dhe një qendër tranziti për migrantët e çregullt që ofruan objekte të ndara për viktimat e huaja potenciale të trafikimit; të dy objektet mund të ofronin strehë për viktimat meshkuj, femra, si dhe për fëmijët. Qeveria ndau 2.7 milion denarë (\$52.870) në vitin 2016. Qeveria gjithashtu ndau 382.950 denarë (\$7.500) për të mbështetur shërbime dhe siguri për viktimat, krahasuar me përafërsisht 1 milion denarë (\$19.580) në vitin 2016. Qeveria nuk dha grante për OJQ-të në vitin 2016 ose 2017; OJQ-të raportuan që vartësia nga këto grante i detyroi ato që të reduktojnë shërbimet për viktimat. Vëzhguesit raportuan se qeveria mbështetej shumë tek finansimi nga komuniteti ndërkombëtar dhe në OJQ-të për të ofruar ndihmë. Për shkak të buxhetit të kufizuar strehimorja e drejtuar nga qeveria u hap vetëm atëherë kur autoritetet identifikuan një viktimë zyrtare të trafikimit. Strehimorja e drejtuar nga qeveria u lejoi viktimave lirinë e lëvizjes, por objekti i migrantëve nuk u lejoi viktimave të huaja potenciale të dalin pa leje qëndrimi të përkohshëm. GRETA raportoi që objekti i migrantëve ishte në "gjendje të dobët materiale" dhe "në dukje një objekt paraburgimi që nuk ishte ambient i përshtatshëm për viktimat e trafikimit," si dhe raportoi që në objekt ka pasur minorenë të pashoqëruar dhe fëmijë që janë viktimë potenciale të trafikimit në vitet e fundit. Strehimorja e drejtuar nga qeveria akomodoi pesë fëmijë viktimë gjatë periudhës së raportimit dhe objekti i migrantëve strehoi 131 të huaj në vitin 2017. Ligji u lejoi viktimave një periudhë dy mujore reflektimi që të vendosin nëse do të dëshmojnë kundër trafikantëve të tyre, e ndjekur nga një leje qëndrimi gjashtë mujore, pa marrë parasysh nëse dëshmonin; asnjë viktimë e huaj nuk kërkoi leje qëndrimi në vitin 2016 ose 2017.

Qeveria nuk i ndëshkoi viktimat e trafikimit për akte joligjore të kryera si rezultat direkt i të qenurit i nënshtruar trafikimit; megjithatë, qeveria mund të ketë deportuar, ndaluar ose kufizuar lirinë e lëvizjes disa viktimave të trafikimit për shkak të përpjekjeve joadekuate të identifikimit. Qeveria nuk e raportoi numrin e viktimave potenciale që ndihmuan në hetime fillestare (12 në vitin 2016) dhe pesë nga gjashtë viktimat zyrtarisht të identifikuar dhanë deklaratat kundër trafikantëve të supozuar (dy në vitin 2016). Akademia për gjykatës dhe prokurorë publikë trajnoi 76 zyrtarë për mosndëshkimin dhe identifikimin e viktimave. Qeveria raportoi që asnjë viktimë nuk kërkoi shërbime të mbrojtjes së dëshmitarëve në vitin 2016 ose 2017. Derisa viktimat mund të kërkonin dëmshpërbim përmes procedurave civile, asnjë viktimë nuk arriti me sukses të kompletojë një kërkesë për shkak të kompleksitetit të procesit. Qeveria dhe shoqëria civile i vazhduan përpjekjet për të zhvilluar një fond për kompensimin e viktimave që u lejoi autoriteteve të ndajnë kompensim për viktimat nga pasuritë kriminale të konfiskuara.

PARANDALIMI

Qeveria i vazhdoi përpjekjet e parandalimit. Komisioni Kombëtar (KK), i cili përbëhet nga agjensitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare, dhe OJQ-të, mbajti takime të rregullta dhe

publikoi një raport vjetor të aktiviteteve të tij. Qeveria emëroi një koordinator kombëtar të ri në korrik të vitit 2017, i cili e udhëhoqi KK dhe i koordinoi përpjekjet kundër trafikimit. Vëzhguesit raportuan për një komunikim dhe bashkëpunim të shtuar në mes shoqërisë civile dhe qeverisë për shkak të koordinatorit kombëtar. Megjithatë, raportuesi nacional nuk prodhoi një vlerësim publik për të tretin vit me rradhë. Koordinatori kombëtar, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, nisi një fushatë një muajshe vetëdijesimi. Komisioni Kombëtar distribuoi përafërsisht 1.500 fletëpalosje vetëdijesimi për publikun e përgjithshëm dhe MPB-ja organizoi 11 tryeza të rrumbullakta dhe 249 ligjerata në shkolla për të ngritur vetëdijen. Qeveria u ndihmoi tre komisioneve lokale kundër-trafikimit (Prilep, Gevgelija, Veles) në zhvillimin e planeve aksionare lokale të para për trafikim. Qeveria nuk drejtoi një linjë të posaçme të pandërprerë, por MPB-ja menaxhoi një aplikacion për të raportuar shkelje të ndryshme, përfshirë trafikimin; aplikacioni pranoi një raportim në lidhje me trafikimin, por nuk rezultoi në një investigim. Qeveria, në partneritet me OJQ-të organizuan seminare për studentët Romë, mësuesit, dhe OJQ-të, mbi rrezikun e martesave të detyruara të minoreneve. Vëzhguesit raportuan raste të fëmijëve romë që nuk janë të regjistruar në lindje, prindërit e të cilëve nuk kishin çertifikata dhe dokumente identifikimi për të pasur qasje te përkujdesja shëndetsore, mbrojtja sociale, dhe arsimimi. Qeveria nuk bëri përpjekje për të ulur kërkesën për akte seksuale komerciale ose të punës së detyruar. Qeveria i paralajmëroi qytetarët që udhëtojnë jashtë shtetit në lidhje me ofertat mashtruese të punësimit në Zonën e Shengenit.

PROFILI I TRAFIKIMIT

Siç është raportuar gjatë pesë viteve të fundit, Maqedonia është një burim, vend tranziti dhe një vend destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët e nënshtruar trafikimit për seks dhe punë të detyruar. Gratë dhe vajzat në Maqedoni u janë nënshtruar trafikimit për seks dhe punë të detyruar brenda shtetit nëpër restorante, bare dhe klube nate. Viktimat e huaja të nënshtruara trafikimit për seks në Maqedoni zakonisht vijnë nga Europa Lindore, veçanërisht nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Rumania, Serbia, dhe Ukraina. Qytetarët e Maqedonisë dhe viktimat e huaja që kalojnë nëpër Maqedoni i nënshtrohen trafikimit për seks dhe punë të detyruar në sektorin e ndërtimitarisë dhe bujqësisë në Europën Jugore, Qendrore, dhe Perëndimore. Fëmijët, kryesisht romë, i nënshtrohen lypjes së detyruar dhe trafikimit për seks nëpërmjet martesave të detyruara. Migrantët dhe refugjatët që udhëtojnë ose kontrabandohen nëpër Maqedoni rrezikojnë trafikimin, veçanërisht gratë dhe minorenet e pashoqëruar. Trafikantët shpesh i japin rryshfet policisë dhe inspektorëve të punës. Oficerë policie janë hetuar dhe dënuar për bashkëfajësi në trafikimin e e qenieve njerëzore.